



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 579/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---------------|------------|
| Jonaid Myzyri | Kryetar |
| Enkeleda Bega | Nënkryetar |
| Vilma Zhupaj | Anëtar |
| Lindita Skeja | Anëtar |
| Merita Zeqaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 16.12.2020 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “M.C Catering” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-75023-10-13-2020, me objekt Loti 1 “Blerje vezë”, me fond limit 6.500.319 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 26.10.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues: “Nelsa” sh.p.k.
Lagja “Qesarak”, Rruga Tiranë – Dajt, Zona Kadastrale 2460, me Nr.pasurie 199/32, Hyrja 1, Dajt, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Sheshi “Skënderbej”, Nr.3, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima façie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përçaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 14.10.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-75023-10-13-2020, me objekt Loti 1 “*Blerje vezë*”, me fond limit 6.500.319 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 26.10.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 26.10.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 29.10.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|---------------------------|-----------------------------|
| 1. "M.C Catering" sh.p.k. | 5.515.440 lekë, kualifikuar |
| 2. "Nelsa" sh.p.k. | 5.829.118 lekë, kualifikuar |

II.4. Në datën 05.11.2020 operatori ekonomik "Nelsa" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "M.C Catering" sh.p.k., me arsyetimin si më poshtë vijon:

[...]

Ne lidhje me kualifikimin e ofertes se operatorit ekonomik "M.C CATERING", bazuar ne dyshime te arsyeshme nuk duhet te ishte kualifikuar pasi ky i fundit nuk permbush kriteret e pergjithshme te kualifikimit/ pranimit si edhe kriteret e vecanta dhe se kualifikimi i ketij te fundit eshte kryer ne kundërshtim me nenin 46,53 te ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar.

1. Se pari, ne lidhje me plotesimin e kapacitetit ekonomik dhe financiar, kemi dyshime te arsyeshme se ne daten e zhvillimit te tenderit operatori ekonomik "M.C CATERING" ka detyrime tatimore te pa shlyera. Ne nenin 45 pika 2 "d" dhe "dh" te ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar thuhet se: 11 2. Cdo operator ekonomik skualifikohet nga nje procedure, ne rastet kur: d) nuk i ka permbushur detyrimet per derdhjen e kontributeve te sigurimeve shoore, ne perputhie me legjislacionirz shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme ne shtetin e origjines; dh) nuk i ka permbushur detyrimet per pagimin e tatimore, ne perputhie me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme ne shtetin e origjines; Ndaj, bazuar edhe ne dokumentet e tenderit, eshte detyrim qe autoriteti kontraktor te verifikojë shtojcen 5 "Deklarata per permbushjen e Krieteve te Pergjithshme", ku edhe parashikohet se: "Ne cdo rast, autoriteti konirakior lea te drejte te kryeje verifikimet e nevojshme mbi vertetesine e informacionit te deklaruar nga operatori ekonomik si me siper."

Gjithashtu ne teresi, operatori dhe nese oferta eshte paraqitur si bashkim operatoresh keto te fundit nuk plotesojne kapacitetin teknik/ financiar dhe ligjor ne perputhje me nenin 74 pika 3 te Vendirnit nr. 914 date 29.12.2014 te Keshillit te Ministrave "Per mriatimin e rregullave te prokurimit publik" te ndryshuar.

2. Ne shtojcen 8, "Kriete te Vecanta te Kualifikimit" eshte parashikuar se operatori ekonomik duhet te paraqese: "Vertetimin qe konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjise elektrike te kontratave te energjise qe ka operatori ekonomik qe eshte i regjistruar ne Shqiperi.

Bazuar ne dyshime te arsyeshme vleresojme se operatori ekonomik "M.C CATERING", apo edhe operatori me te cilin ky operator ekonomik mund te kete marre pjese ne kete procedure ne marredhenie bashkepunimi ose furnizimi, ne daten e zhvillirnit te procedures se prokurimit objekt ankimi nuk kane shlyer detyrimet e energjise duke perfshire muajin Gusht 2020.

Gjithashtu ne teresi, operatori dhe nese oferta eshte paraqitur si bashkim operatoresh keto te fundit nuk plotesojne kapacitetin teknik/ financiar dhe ligjor ne perputhje me nenin 74 pika 3 te Vendimit nr. 914 date 29.12.2014 te Keshillit te Ministrave "Per mriatimin e rregullave te prokurimit publik" te ndryshuar.

3. Ne shtojcen 8 "Kriete e Vecanta te Kualifikimit", "Kapaciteti ligjor/profesional I operatoreve ekonomike" eshte parashikuar se: 1.Operatori ekonomik pjesemarres duhet te paraqes Licence te

kategorise "II.1.A.1 - Prodhim, perpunirn dhe shperndarie me shumice e ushqimeoe per nierez", ose Licence te kategoriee "II.1.B- Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore (per njerez)" ne emer te tij, te leshuar nga Qendra Kombeiare e Biznesit (nuk lejohet perdorimi i Licences se nje operatori tjeter ekonomik, sipas Rekomandimii te perbashket te APP-se dhe AKU-se te dates 19.11.2018).

Ne nenin 46 pika 1 germa "a" te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar parashikohet se: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: cdo operatori ekonomik i kerkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, ie leshuara nga autoritetet kompetente shteterore, per veprimtarite e kerkuara dhe per te cilat do te lidhe kontrata; Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushje me sukses te kontrates. Bazuar ne dyshime te arsyeshme vleresojme se operatori ekonomik M.C CATERING, apo edhe operatori me te cilin ky operator ekonomik mund te kete marre pjese ne kete procedure ne marredhenie bashkepunirni ose furnizimi nuk disponojne licencen II.1.A.1- Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez", ose Licence te kategorise II.1.B- Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore (per njerez)", te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit.

Gjithashtu ne teresi operatori edhe nese oferta eshte paraqitur si bashkim operatoresh keto te fundit nuk plotesojne kapacitetin teknik/ financiar dhe ligjor ne perputhje me nenin 74 pika 3 te Vendimit nr. 914 date 29.12.2014 te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" te ndryshuar.

4. Ne shtojcen 8, "Kritere te Vecanta te Kualifikimit", "Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike: eshte parashikuar se: "2) Operatori ekonomik pjesemarres, duhet te paraqes nje certifikate qe verteton cilesine e menaxhimit te shoqerise, sipas standardit nderkombetar ISO 9001 ose ekuivalent. Certifikata duhet te jeti ne fuqi, e vlefshme ne kohen e zhvillimit te procedures dhe te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit akredituar nga organizmi kombetar i akreditimii ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise. 3) Operatori ekonomik pjesemarres, duhet te paraqes nje certifikate qe verteton cilesine e sistemit te menaxhimii te sigurise ushqimore. sipas standardit nderkombetar ISO 22000 ose ekuivalent. Certifikata duhet te jete ne fuqi, e vlefshme ne kohen e zhvillimit te procedures dhe te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimii ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise. 4) Operatori ekonomik duhet te paraqese nje certifikate qe verteton sistemin e menaxhimii te mjedisit, sipas standardit nderkombeiar ISO 14001 ose ekuivalent. Certifikata duhet te jete ne fuqi, e vlefshme ne kohen e zhvillimit te procedures dhe te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise".

Ne nenin 46 pika 1 germa "a" te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar parashikohet se: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjesetim me natyren

dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: cdo operatori ekonomik i kerkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, te leshuara nga autoritetet kompetente shteterore, per veprimtarite e kerkuara dhe per te cilat do te lidhet kontrata; Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbiishje me sukses te kontrates. Bazuar ne dyshime te arsyeshme vleresojme se operatori ekonomik "M.C CATERING", apo edhe operatori me te cilin ky operator ekonomik mund te kete marre pjese ne kete procedure ne marredhenie bashkepunimi ose furnizimi nuk disponojne te tre certifikata e kerkuara ne kete procedure (ISO 9001 ose ekuivalent; 22000 ose ekuivalent dhe ISO 14001 ose ekuivalent). Pra kemi dyshime te arsyeshme se operatori ekonomik M.C CATERING apo edhe operatori me te cilin ky operator ekonomik mund te kete marre pjese ne kete procedure ne marredhenie bashkepunimi ose furnizimi nuk disponojne: Certificate te Menaxhimit te Cilesise ISO 9001 ose ekuivalente; Certificate te Sistemit te Menaxhimit te Sigurise Ushqimore ISO 22000 ose ekuivalente ose Certificate te Sistemit te Menaxhimit Mjedisor ISO 14001 ose ekuivalent ose edhe nese i disponojne keto certifikata nuk jane te treja vlefshme ne ditet e zhvillimit te procedures objekt ankimi.

Gjithashtu ne teresi operatori edhe nese oferta eshte paraqitur si bashkim operatoresh keto te fundit nuk plotesojne kapacitetin teknik/ financiar dhe ligjor ne perputhje me nenin 74 pika 3 te Vendirnit nr.914 date 29.12.2014 te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" te ndryshuar.

5. Ne shtojcen 8 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", "Kapaciteti teknik", eshte parashikuar se: l) Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per furnizimet e meparshme te ngjashme, te kryera gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures, ne vleren prej te pakten 40 % te vleres se fondit te marreveshjes kuader te ketij Loti. Keto furnizime te ngjashme duhet te vertetohen me dokumentacionin si me poshte:

a) Autoriteti kontraktor si deshmi per pervojen e meparshme kerkon vertetime te leshuara nga nje ent publik ose fatura tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.

b) Kur furnizimet e ngjashme jane realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet te paraqese faturen perkatese tatimore te shitjes ku te shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara."

Ne nenin 46 pika 1 germa "c" te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar parashikohet se: [...]

Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorama te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushje me sukses te kontrates.

Bazuar ne dyshime te arsyeshme vleresojme se operatori ekonomik "M.C CATERING", apo edhe operatori me te cilin ky operator ekonomik mund te kete marre pjese ne kete procedure ne marredhenie bashkepunimi ose furnizimi nuk disponojne furnizimet e meparshme te ngjashme vetem per produktin "veze", te kryera gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures 26.10.2020, ne vleren prej te pakten 40 % te vleres se fondit te marreveshjes kuader te ketij Loti. Edhe neqoftese keto operatore zoterojne furnizime te meparshme ne vleren prej te pakten 40 % te vleres se fondit limit te ketij loti kerkojme qe te behen verifikime te metejshme persa i perket permbushjes se ketij kriteri pasi kontratat e ngjashme duhet te jene vetem per produktin e

vezes. Pra kemi dyshime te arsyeshme se operatori ekonomik M.C CATERING, apo edhe operatori me te cilin ky operator ekonomik mund te kete marre pjese ne kete procedure ne marredhenie bashkepunimi ose furnizimi nuk disponojne furnizime te produktit te vezeve ne nje vlere jo me pak se 40% e fondit limit te ketij loti.

6. Ne shtojcen 8, "Kritere te Vecanta te Kualifikimit", "Kapaciteti teknik". eshte parashikuar se:
2) Operatori ekonomik piesemarres. duhet te keie te punesuar per periudhen 3-mujore Korrik 2020 - Shtator 2020, nje staf punonjesish prej minimalisht 2 (dy) persona. Per stafin e punonjesve ofertuesi duhet te paraqese:

a) Vertetim per kontributet e sigurimeve shoore e shendetesore leshuar nga administrata tatimore;

b) Listepagesat e deklaruar ne organe tatimore per periudhen Korrik 2020 - Shtator 2020."

Ne nenin 46 pika 1 germa "b" te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar parashikohet se: [...]

Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorama te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushje me sukses te kontrates.

Bazuar ne dyshirne te arsyeshrne vleresojme se operatori ekonomik M.C CATERING, apo edhe operatori me te cilin ky operator ekonomik mund te kete marre pjese ne kete procedure ne marredhenie bashkepunimi ose furnizimi nuk kane te punesuar per periudhen 3-mujore Korrik - Shtator 2020, nje staf punonjesish prej minimalisht 2 (dy) persona. Edhe nese keta operatore ekonomik kane ne kete periudhe kohore nje staf minimalisht prej kater personash kemi dyshime te arsyeshme qe nese keta operatore ekonomike vecmas apo si bashkim operatoresh kane marre pjese ne me shume se nje lot per proceduren e zhvilluar nga autoriteti juaj kontraktor, nuk e permbushin kete kriter duke mos patur nje staf sa shuma e loteve per te cilat kane ofertuar, te marra se bashku.

7. Ne shtojcen 8, "Kritere te Vecanta te Kualifikimit", "Kapaciteti teknik" eshte parashikuar se:
"3) Operatori ekonomik piesemarres duhej te disponoje te pakten 1 (nje) automjet te pershtatshme ATV (frigorifer), me qellim transportin e mallrave, te cilin duhet ta kete ne pronesi ose me qira dhe per te cilin duhet te paraqese dokumentacionin perkates, si me poshte:

a) Dokumentacioni qe oerieton proneeine ose marrjen me qera:

- Dokumentacioni qe verteton pronesine:

- Certifikata e pronesise e leshuar nga instiucioni autorizuar me ligj / Kotrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit / Cdo dokumenti tjeter me ane te te cilit fitohet e drejta e pronesise sipas Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

- Dokumentacioni qe verteton marrjen me qira:

- Kontrate qiraje.

b) Leje qarkullimi e mjetit;

c) Certifikate e kontrollit teknik te mjeteve rrugore;

d) Police per sigurimin e detyrueshem te mjeteve;

e) Certifikate per transport mallrash (e detyrueshme vetem per mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton);

f) Akt miratimi higjeno - san.itar;

g) Leje drejtimi automjeti, per te pakten 1 (nje) prej punonjesve."

Ne nenin 46 pika 1 germa "b" te ligjit m.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar parashikohet se: [...].

Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorarne te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbiishje me sukses te kontrates. Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, si edhe specifikimet teknike duke mbajtur ne konsiderate kufijte maksimal te percaktuara ne rregullat e prokurimit publik. Bazuar ne dyshime te arsyeshme vleresoyme se operatori ekonornik "M.C CATERING" apo edhe operatori me te cilin ky operator ekonomik mund te kete marre pjese ne kete procedure ne marredhenie bashkepunimi ose furnizimi, nuk disponojne mjet ATV me dokumentacionin e rregullt, "Leje qarkullimi e mjetit; Certifikate e kontrollit teknik te mjeteve rrugore; Police per sigurimin e detyrueshem te mjeteve; Certifikate per transport mallrash (e detyrueshme vetem per mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton); Akt miratimi higjeno - sanitar; ", sic kerkohet edhe ne kriteret e kualifikimit.

Gjithashtu kemi dyshime se ne dokumentacionin e dorezuar nga ky operator ekonomik ne rast se keto mjete jane me qira, kontrata e qirase qe eshte dorezuar ka perfunduar dhe nuk eshte me e vlefshme.

Bazuar ne dyshime te arsyeshrne gjithashtu kerkojme te verifikohet edhe leja e drejtimit te drejtuesit te automjetit te dorezuar pasi kemi dyshime te arsyeshme se ne periudhen e zhvillimit te procedures objekt ankimi kjo leje drejtirni nuk eshte e vlefshrne pasi i ka perfunduar afati i perdorimit dhe nuk eshte rinovuar.

8. Ne shtojcen 8 mbi "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", "Kapaciteti teknik" eshte parashikuar se: 4) Operatori ekonomik pjesemarres, duhet te kete ne pronesi ose ne perdorim te pakten 1 (nje) ambient te pershtatshem per prodhimin ose tregtimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi, me sipërfaqe te pakten 20 m2, per te cilin duhet te paraqes dokumentacionin perkates, si me posnte:

a) Dokumentacioni qe verteton pronesine ose huaperdorjen ose qiramarrjen:

- Dokumentacioni qe verteton pronesine:

- Certifikata e pronesise e leshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / kontrata e shitblerjes / kontrata e dhurimit / cdo dokument tjeter me ane te se cilit fitohet e drejta e pronesise sipas kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

- Dokumentacioni qe verteton huaperdorjen:

- Kontrate noteriale huaperdorje.

- Dokumentacioni qe verteton marrjen me qira:

- Kontrate noteriale qiraje.

b) Akt miratimi higjeno - sanitar per kete ambient, leshuar nga organi kompeient i ngarkuar me ligj.

c) Certifikate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, leshuar nga organi kompetent ngarkuar me ligj.

d) Operaiori ekonomik pjesemarres duhet te deklarroje plotesimin e standarteve tekniko-teknologjike per kete ambient.

e) Foto te ambieniii te brendshem te prodhimit ose tregtimit ose magazinimit te mallrave objekt prokurimi.

Ne nenin 46 pika 1 germa "b" te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar parashikohet se: [...].

Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushje me sukses te

kontrates. Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, si edhe specifikimet teknike duke mbajtur ne konsiderate kufijte maksimal te percaktuara ne rregullat e prokurimit publik.

Bazuar ne dyshime te arsyeshme vleresojme se operatori ekonomik "M.C CATERING" apo edhe operatori me te cilin ky operator ekonomik mund te kete marre pjese ne kete procedure ne marredhenie bashkepunimi ose furnizimi, nuk disponojne ne pronesi ose ne perdorim te pakten 1 (nje) ambient te pershtatshem per perpunimin ose tregtimin ose magazinimin e vezeve, me sipërfaqe te pakten 20 (njezet) m², shoqeruar me dokumentacionin perkates qe verteton disponueshmerine e ketij mjedisi dhe faktin qe ky mjedis i ploteson kushtet e nevojshme higjieno sanitare dhe tekniko teknologjike dhe foto te ambjenteve.

9. Ne shtojcen 8, "Kritere te Vecanta te Kualifikimit", "Kapaciteti teknik" eshte parashikuar se: "5) Operatori ekonomik pjesemarres, duhet te paraqes nje deklarate, me ane te se ciles duhet te vetedeklaroje se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombetar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kerkesave ligjore. Ne rast se operatori ekonomik pjesemarres do te shpallet fitues, perpara lidhjes se marreveshjes kuader ka detyrimin te paraqese dokumentacionin provues ne lidhje me kontrollin e fundit te ushtruar nga Autoriteti Kombetar i Ushqimit, per te provuar ushtrimin e aktivitetit konform kerkesave ligjore."

Bazuar ne dyshime te arsyeshme vleresojme se operatori ekonomik "M.C CATERING" apo edhe operatori me te cilin ky operator ekonomik mund te kete marre pjese ne kete procedure ne marredhenie bashkepunimi ose furnizimi nuk kane paraqitur nje deklarate me ane te se ciles te vete deklarojne se nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombetar i Ushqimit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kerkesave ligjore. Ose ne rast te nje marredhenie bashkepunimi kemi dyshime te arsyeshme se kjo deklarate nuk eshte paraqitur nga te gjithë operatoret e bashkimit te operatoreve.

10. Ne shtojcen 8, "Kritere te Vecanta te Kualifikimit", "Kapaciteti teknik" eshte parashikuar se: "6) Operatori ekonomik pjesemarree, duhet te paraqes nje deklarate, me ane te se ciles merr persiper te kryeje sherbimin e transportit, ne adresat e autoriteteve kontraktore".

Bazuar ne dyshime te arsyeshme vleresojme se operatori ekonomik "M.C CATERING" apo edhe operatori me te cilin ky operator ekonomik mund te kete marre pjese ne kete procedure ne marredhenie bashkepunimi ose furnizimi nuk kane paraqitur nje deklarate me ane te se ciles merr persiper te kryeje sherbimin e transportit, sipas kerkeses dhe ne adresat e autoriteteve kontraktore. Ose ne rast te nje marredhenie bashkepunimi kemi dyshirne te arsyeshme se kjo deklarate nuk eshte paraqitur nga bashkimi i operatoreve ne varesi te perqindjes dhe sherbimeve qe do te mbuloje secili operator ekonomik te specifikuara ne kontraten e bashkepunimit.

Sa me siper, vleresojme se oferta e shoqerise tone eshte oferta me e ulet e cila ploteson te gjithë kriteret e pergjithshme te kualifikimit/ pranimit dhe kriteret e vecanta.

Sa me siper kerkojme:

1. Pranimin e ankeses
2. Pezullimin e procedures se prokurimit
3. Skualifikimin e ofertes se operatorit ekonomik "M.C CATERING"

II.5. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit më anë të shkresës nr.2227/2 prot, datë 09.11.2020, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “Nelsa” sh.p.k., duke e refuzuar atë.

II.6. Në datën 18.11.2020 operatori ekonomik “Nelsa” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 2356/1 prot., datë 27.11.2020, protokolluar me tonën në datën 02.12.2020, me objekt *“Dërgim dokumentacioni për Lotin 1 “Blerje vezë” për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje artikuj ushqimorë”, e ndarë në 2 (dy) Lote”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.*

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Nelsa” sh.p.k. mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “M.C Catering” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se,

III.1.1. Në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë K.P.P, operatori ekonomik ankimues nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori* për të gjithë kriteret në total, duke ngritur dyshime e hamendësime, nëse i plotëson kriteret e vendosura në DST operatori ekonomik “M.C Catering” sh.p.k, i kualifikuar në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.2. Akoma më tej, referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetençës lëndore, legjitimitit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshëm të ankesës” sipas përçaktimeve të nenit 20, “Forma dhe përmbajtja e ankesës”, pika 3:*

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;”*

III.1.3. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumenta ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë.

Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 e 65 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e Autoritetit Kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.1.4. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë.

Theksojmë se mospërbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërbushje kriteri/kritereve.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.1.6. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimuesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar efijencën e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krah të operatorit ankimues. Në rastin e dytë, kur operatori pjesmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrojnë pretendime a-priori duke iu referuar të gjithë kritereve të veçanta të kualifikimit duke mos identifikuar asnjë element konkret brenda kritereve të veçanta të kualifikimit, si edhe duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij. Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “*onus probandi incumbit actori*” se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjithë elementët proceduralë, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik. Konkretisht, neni 21 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” të ndryshuar, parashikon se: “*Informacioni i administruar, sipas nenit 12 të këtij ligji, i vihet në dispozicion çdo personi të interesuar, palë në proces, me kërkesë të tij, pasi ka përfunduar klasifikimi i ofertave. Autoriteti kontraktues është i detyruar ta vërë në dispozicion informacionin brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës*”, ndërkohë në nenin 25 të tij parashikohet se “*Pa cenuar dispozitat e këtij ligji mbi detyrimin për botimin e kontratave të prokurimit dhe të informacioneve për kandidatët dhe ofertuesit, sipas neneve 21 e 57 të këtij ligji, autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë publik informacionet e marra nga operatorët ekonomikë, të etiketuara si konfidenciale. Ky lloj informacioni përfshin veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave.*”.

III.1.7. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.1.8. KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Nelsa” sh.p.k. nuk qëndrojnë.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Nelsa” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-75023-10-13-2020, me objekt Loti 1 “*Blerje vezë*”, me fond limit 6.500.319 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 26.10.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1524 Protokolli

Datë 18.11.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri